



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJETLLËS KANALIZIME ELBASAN sha

Elbasan, më 12.08.2025

PROCES-VERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale ndertimi, tubo per KUN”

Procedurë e hapur e thjeshtuar, mallra

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44163130-0
Tuba kanalizimesh

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,998,954 (dymilion e nenteqind e nentëdhjetë e tete mije e nenteqind e pesëdhjetë e kater) Lekë, pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria **UK Rajoni Elbasan**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

a) të ketë të shënuar në license artikujt objekt prokurimi

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të tenderit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe neni 43 dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe

të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

1.2.2 Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DT , shtojca 6, Specifikimet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në ditën e hapjes së ofertave mostra për mallrat furnizues, të cilat duhet të dëshmojnë qartë që cilësia e tubove është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara (për secilin diametër tubo nga 0.5 deri në 1 (një) m/ l). para Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bejë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat. Mosparaqitja e të gjitha mostrave është kusht skualifikim.

Tabela e artikujve që kerkohen mostra:

Nr.	Emërtimi i artikujve	Specifikimet Teknike	Njësia
6	Bojë Plastike e bardhe (Kuti 3 litra)	Boja duhet të jetë e ambalazhuar në kuti plastike 3 litra secila, te jete bojë ekologjike plastike me cilësi të shkëlqyer për lyerjen e zyrave, (përdorim të brendshëm). Te paraqes mbulueshmëri të mirë, bardhësi dhe jetëgjatësi të ngjyrave të aplikuara. Paketimi: 3 L Koha e tharjes: Koha e plote e tharjes 25 ± 5 min Dora e dyte 60 ± 10 min Hollimi: Me 5-10% ne volum	copë(kuti)

12	Tub -HDPE -i-brinjëzuar SN 8- Ø 200	Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN8 (8 kN/m²) DN 200, Tubot të jenë nga një anë me gotë (krykë) çiftimi, shoqëruar me guarnicion Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të brendshëm (ID) të tubove (± 2%). Këto tuba (DN 200) janë me mure të dyfishta: muri i jashtëm i brinjëzuar, dhe muri i brendshëm me sipërfaqe të lëmuar. Shtresa e jashtme ka zakonisht ngjyrë të zezë kurse shtresa e brendshme ngjyrë të çelur. Tubot duhet të jenë polietile ose derivate të tyre. Çdo tub duhet të ketë të shënuar në trup të saj, të dhënat si më poshtë: - Emrin e prodhuesit - Diametri i tubos Ky shënim duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shënuar në mënyrë rezistente (permanente). Tubot duhet të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike. Gjatësia e tubove duhet të jetë 6 m	m/l
----	--	--	-----

13	Tub -HDPE -i-brinjëzuar 8- Ø 315	SN	Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN8 (8 kN/m²) DN 315, Tubot të jenë nga një anë me gotë (krykë) çiftimi, shoqëruar me guarnicion Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të brendshëm (ID) të tubove (± 2%) . Këto tuba (DN 315) janë me mure të dyfishta: muri i jashtëm i brinjëzuar, dhe muri i brendshëm me sipërfaqe të lëmuar. Shtresa e jashtme ka zakonisht ngjyrë të zezë kurse shtresa e brendshme ngjyrë të çelur. Tubot duhet të jenë polietile ose derivate të tyre. Çdo tub duhet të ketë të shënuar në trup të saj, të dhënat si më poshtë: - Emrin e prodhuesit - Diametri i tubos Ky shënim duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shënuar në mënyrë rezistente (permanente). Tubot duhet të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike. Gjatësia e tubove duhet të jetë 6 ml	m/l
----	-------------------------------------	----	--	-----

14	Tub -HDPE -i-brinjëzuar SN 8- Ø 400	Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN8 (8 kN/m²) DN 400, Tubot të jenë nga një anë me gotë (krykë) çiftimi, shoqëruar me guarnicion Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të brendshëm (ID) të tubove (± 2%) . Këto tuba (DN 400) janë me mure të dyfishta: muri i jashtëm i brinjëzuar, dhe muri i brendshëm me sipërfaqe të lëmuar. Shtresa e jashtme ka zakonisht ngjyrë të zezë kurse shtresa e brendshme ngjyrë të çelur. Tubot duhet të jenë polietile ose derivate të tyre. Çdo tub duhet të ketë të shënuar në trup të saj, të dhënat si më poshtë: - Emrin e prodhuesit - Diametri i tubos Ky shënim duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shënuar në mënyrë rezistente (permanente). Tubot duhet të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike. Gjatësia e tubove duhet të jetë 6 ml	m/l
----	--	--	-----

15	Tub -HDPE -i-brinjëzuar SN 8- Ø 500	Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN8 (8 kN/m²) DN 500, Tubot të jenë nga një anë me gotë (krykë) çiftimi, shoqëruar me guarnicion Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të brendshëm (ID) të tubove (± 2%) . Këto tuba (DN 500) janë me mure të dyfishta: muri i jashtëm i brinjëzuar, dhe muri i brendshëm me sipërfaqe të lëmuar. Shtresa e jashtme ka zakonisht ngjyrë të zezë kurse shtresa e brendshme ngjyrë të çelur. Tubot duhet të jenë polietile ose derivate të tyre. Çdo tub duhet të ketë të shënuar në trup të saj, të dhënat si më poshtë: - Emrin e prodhuesit - Diametri i tubos Ky shënim duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shënuar në mënyrë rezistente (permanente). Tubot duhet të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike. Gjatësia e tubove duhet të jetë 6 m	m/l
----	-------------------------------------	---	-----

16	Tub -HDPE -i-brinjëzua SN 8- Ø 630	Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN8 (8 kN/m2) DN 630, Tubot të jenë nga një anë me gotë (krykë) çiftimi, shoqëruar me guarnicion Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të brendshëm (ID) të tubove (± 2%) . Këto tuba (DN 630) janë me mure të dyfishta: muri i jashtëm i brinjëzuar, dhe muri i brendshëm me sipërfaqe të lëmuar. Shtresa e jashtme ka zakonisht ngjyrë të zezë kurse shtresa e brendshme ngjyrë të çelur. Tubot duhet të jenë polietile ose derivate të tyre. Çdo tub duhet të ketë të shënuar në trup të saj, të dhënat si më poshtë: - Emrin e prodhuesit - Diametri i tubos Ky shënim duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shënuar në mënyrë rezistente (permanente). Tubot duhet të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike. Gjatësia e tubove duhet të jetë 6 ml.	m/l
----	------------------------------------	--	-----

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderi mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike...

2.2.3 Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DT , shtojca 6 Specifikimet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **katalogë teknike për të gjithë** mallrat furnizues, **ku të jepet qartë** që mallrat janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, fotografitë apo katalogët teknikë; që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderi, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike...

2.2.4 Furnizuesi duhet që të gjitha materialet t'i shoqërojë me çertifikatën e prodhuesit ose me autorizim /deklarate nga prodhuesi , që vërteton përputhjen me specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentimi i specifikimeve teknike është bërë në specifikimet teknike të pasqyruara në shtojcën 6 të DST-së objekt prokurimi.

Njësia e Prokurimit